

Gjon BERISHA

**FUNKSIONIMI DHE IMAZHI I USHTRISË VENEDIKASE NË
ARBËRI NË FUND TË SHEK.XIV- FILLIMI I SHEK.XV**

Potenciali ushtarak dhe militarizimi i Arbërisë

Siç na tregojnë dokumentet venedikase, numri i ushtarëve italianë të vendosur përherazi në Arbëri ishte tepër i vogël. Të gjithë armbajtësit e tjerë ishin vendas. Sundimi venedikas nuk mbështetej mbi ndonjë prani të vazhdueshme ushtarake. Sikurse funksionarët ashtu edhe prania e trupave ushtarake ishte mjaftë modeste, ndonëse Arbëria bënte pjesë në sundimet më të trazuara të *Stato da Màr*.¹ Kjo vinte, ndoshta nga fakti se Venediku duke shfrytëzuar rrethanat shoqërore në vend dhe ngjarjet politike të kohës, sidomos rreziku i përshpejtuar që i kanosej shqiptarëve nga osmanët, të fitonte për vete shumicën dërmuese të nënshtetasve të vet.

Edhe në konfliktet më të mëdha, Senati dërgonte në Arbëri jo më shumë se disa qindra ushtarë. Më 1404 u rekrutuan vetëm 40 harkëtarë-balestarë,² në kryengritjen e viti 1405 jo më shumë se 100 ushtarë këmbësorë,³ gjatë luftimeve të vitit 1409 kundër Balshajve ishin vetëm 200 mercenarë të huaj,⁴ tri vite më vonë, këto trupa do të shtoheshin me 300 kalorës dhe 200 këmbësorë të huaj.⁵ Kryengritjet më të fuqishme antivenedikase shpërthyen midis viteve 1399 dhe 1421, në varësi të ngushte nga konflikti midis Republikës së Shën Markut dhe Balshajve. Në këto vite

¹ Më gjerësisht për Arbërinë Venedike, shiko: Oliver Jens Schmitt, *Arbëria venedike: 1392-1479*, Tiranë: K&B, 2007.

² Giuseppe [Joseph] Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, etc., 1967-1972, [më tej: AAV], AAV/III, no.1094, pp.442-443.

³ Fillimisht thuhej se ishin inkadruar 300 "...ccc hominess (?)", AAV/III, no.1050, pp.490-491.

⁴ AAV/V, no.1427, pp.240-242.

⁵ AAV/VI, no.1773.

bëjnë pjesë edhe luftimet kundër osmanëve. Nga kjo periudhë e rezistencës antivendikase, dallohet periudha e ngjijtes në fron të Balshës III (1403) si një sundimtar shpresëdhënës dhe figurë simbol i forcave antivenedikase, ndonëse nuk arriti kurrë në një fitore përfundimtare.⁶ Kundërshtitë ndaj venedikasve pësuan rënie të theksuar në njëjtën kohë me rënien e dinastisë së Balshajve (më 1421), që përbënte edhe pikën kryesore të referimit për krahun antivenedikas.

Në aspektin ushtarak, në vitet e para të sundimit të tij, Venediku mbështetej kryesisht mbi mercenarë (*stipendiarii*) italianë, kurse vendasit, në këtë fazë inkuadrimi i vendasve në ushtri, numerikisht ishte i papërfillshëm. Dhe kjo lidhet edhe me mundësitë ushtarake të Republikës së Venedikut në Arbëri.⁷ Sa i përket fuqisë ushtarake, ajo tokësore ishte kryesorja gjatë gjithë viteve të sundimit venedikas në Arbëri.

Menjëherë pas marrjes së vendeve në Arbëri, Senati e pa të arsyeshme të dërgonte në zotërimet e Republikës mercenarë italianë, të drejtuar nga *kondotierë* e *komestabël*. Është fjala, kryesisht për specialistë të kualifikuar, që mund të përdornin armë si balestrat, artilerinë (bombardat), drejtimin e galerave, etj.⁸ Senati, në vazhdimësi kishte vështirësi të sigurimin e numrit të mjaftueshëm të mercenarëve për të shërbyer në Arbëri, kjo edhe për faktin se luftimet në Arbëri ishin të ashpra dhe ndikonin në shuarjen reparteve ushtarake italiane. Në të vërtetë në Arbëri kishte burra të gatshëm për tu bërë pjesë e ushtrisë venedikase, por Republika nuk u kishte shuam besën vendasve, andaj parapëlqente të huajt. Megjithatë, ajo u detyrua të rekrutonte gjithnjë e më shumë vendas në radhët e saja, pa hequr dorë krejtësisht nga njësitë italiane. Kështu, p.sh., në vitin 1400 në Lezhë gjejmë vetëm ushtarë vendas – 6 deri në 8 ushtarë,⁹ kurse në vitin 1402, trupat me pajime të lehta në Shkodër përbëheshin vetëm nga shqiptarët.¹⁰

Duhet theksuar se trupat mercenare italiane në numër të madh, Venediku i vuri në përdorim vetëm në rast krizash më të mëdha, si në rastin e luftërave kundër Balshajve, osmanëve e boshnjakëve e kundër Skënderbeut. Ndërsa si njësi territoriale ato u zëvendësuan prej fillimit të

⁶ Schmitt, *Arbëria venedike*, 462.

⁷ Ibid., 508.

⁸ AAV/II, no.445, pp.146-148.

⁹ “...in castro nostro alesii, sint ballistarii, sex uel octo albanenses, qui male stant in eo, Vadit pars, Quod noster prouisor,...ad dictum castrum, debeat ducere secum ballistarios sex, qui non sint albanenses, et cum ibi fuerit cassare debeat dictos Albanenses, et loco eorum ponere istos sex.”, AAV/III, no.797, p.151.

¹⁰ “...ibi existen(tes) sint Albanenses...”, AAV/III, no.959, p. 312.

shek.XV, kryesisht me vendas. Dhe kjo kyçje në masë e vendasve si njerëz të besuar “*fideles*” në aparatën e sundimit venedikas, nuk bëhej thjeshtë nga dashamirësia por nga detyrimi dhe nevoja. *Proniarët* shqiptarë, jo vetëm që kërkonin pagesa të mira për shërbimet ushtarake, por përmes kryengritjes së viti 1399 arritën deri aty sa që ta detyronin Republikën që t’i fuste në listat e ushtrisë, kurse me rebelimin vitit 1405 arritën ta pengonin largimin e tyre që ishte tentuar të bëhej në atë kohë.¹¹ Siç është vërejtur me të drejtë nga Schmitt, ushtarët shqiptarë e tregonin veten në mbrojtje të atdheut të tyre (*contra turchos*) më të motivuar sesa mercenarët italianë, duke zotëruar edhe përparësinë e njohjes së terrenit, gjuhën dhe kundërshtarin; ishin më të shkathët sesa kalorësit e rëndë italianë. I vetmi element negativ për ushtarët shqiptarë mund të konsiderohej mos besueshmëria politike që tregonin ndaj Venedikut.¹² Për këto arsye të përmendura, Republika mbrojtjen e brendshme të kështjellave ua besonte trupave italiane, kurse pjesët e poshtme të qyteteve dhe krahinave ua besonte njësive vendase.¹³

Organizimi dhe administrimi i ushtrisë venedikase

Gjatë gjithë shek.XV, organizimi i ushtrisë venedikase vazhdoi të bazohej kryesisht në *condotte* të drejtuara nga *kondotierë*, një post midis kapitenëve individualë dhe shtetëror. Gjatë atij shekulli natyra e marrëdhënies kontraktuale ndryshoi në mënyrë të konsiderueshme. Gjatë gjithë shek.XV, organizimi i ushtrisë venedikase vazhdoi të bazohej kryesisht në *condotte* të drejtuara nga *kondotierë*, një post midis kapitenëve individualë dhe shtetëror.: kontratat u rritën, duke përfshirë shërbimin e luftës dhe të paqes, dhe shumica e kondotierëve u mësuan me shërbimin e përhershëm me rinovimin e kontratave të tyre vetëm sa për formalitet. Kjo shkallë e qëndrueshmërisë në rritje nënkuptonte një nevojë gjithnjë e më të madhe për një administratë të përhershme e cila mbikëqyrte kontratat, kryente inspektime dhe siguronte në mënyrë qendrore nevojat e ushtrisë. Në të njëjtën kohë, pjesë të konsiderueshme të ushtrisë nuk u organizuan në bazë punësimi me kontratë, dhe këto përfshinin një administratë edhe më shumë të centralizuar.¹⁴

¹¹ AAV/VI, no.1589; Schmitt, *Arbëria venedike*, 516-517.

¹² AAV/III, no.768, pp.128-130; Schmitt, *Arbëria venedike*, 517.

¹³ Ibid, 517.

¹⁴ M.E.Mallet, J.R. Hale, *The Military Organization of a Renaissance State: Venice c. 1400 to 1617*, Cambridge: Cambridge University Press, 2006, 101.

Që në fillim të pushtimeve të saj në Arbëri, më 27 mars 1394, Senati urdhëroi që Durrësi të furnizohej me trupa për gjuajtje të pajisur me hark-*balistarë*. Dy vite më vonë (më 21 mars 1396), Venediku vendosi të dërgojë 30 kalorës *balistarë* në Shkodër. Më 11 gusht 1396, ai dekretoi shpërblimin për gjashtë muaj për 70 kalorës të pajisur me shtiza (heshtar) për Durrës dhe Shkodër, nën komandën e shtatë *komestabëve*.¹⁵

Në kohë lufte, numri i ushtarëve dhe në veçanti *balistarëve* (Ushtar i armatosur me hark) përgjegjës për mbrojtjen e kështjellave, rritej. Kështu, më 15 mars 1397, Senati vendosi të dërgojë me shpenzimet e veta katër *balistarë* në kështjellën e Lezhës, të mbrojtur deri atëherë nga dhjetë ushtarë *balistarë*, të cilët rezultuan të pamjaftueshëm përballë ndërhyrjeve turke. Po kështu kur Lezha e gjen veten të kërcënuar, numri i *balistarëve* në kështjellën në fjalë u rrit në 14 burra.¹⁶ Më 3 tetor 1399, Republika e Shën Markut vendosi të paguajë edhe 20 *balistarë* të huaj "*të mirë*" për mbrojtjen e Shkodrës.¹⁷ Më 8 korrik 1400, Senati diskutoi mbi kërkesën e rektorëve të Shkodrës dhe Drishtit, për të dërguar ndihmë. Njëri prej propozimeve ishte që të dërgoheshin 100 ushtarë me heshta. Megjithatë, vendimi u shty deri më 13 korrik të vitit 1400. Gjatë këtij diskutimi, senatorët propozuan pagesën e 50 deri në 60 *balistarëve* dhe 40 deri në 80 *heshtëtarëve*. Së fundi, Senati preferon të presë kthimin e kontit të Shkodrës, Nikollë Polanit, para se të merrej një vendim. Më 3 gusht 1400, ndërsa kërcënimi turk po bëhej gjithnjë e më urgjent, Senati dekretoi dërgimin e 20 *kalorësve* dhe 40 *balistarëve* për mbrojtjen e kalasë së Shkodrës.¹⁸

Po atë kohë, Rektorët e Shkodrës dhe Drishtit informonin Venedikun për vdekjen e një numri të madh të *balistarëve* në këtë qytet, për shkak të përhapjes së epidemisë. Si pasojë, këto dy qytete u mbetën të pambrojtura, gjë që e detyrojë Senatin të dekretoi më 4 gusht 1401, dërgimin e 50 *gjuajtësve-balistarëve* nën komandën e oficerëve ushtarak *komestabël*.¹⁹ Më 3 shkurt 1402, Senati vendosi që të përforconte Durrësin edhe me 25 kalorës tjerë të pajisur me harqe.²⁰ Për të kompensuar humbjet

¹⁵ AAV/II, no.532, pp.235 (*triginta boni ballistarii*); no.615, pp.317-318 (*triginta boni ballestarii cum ilo soldo*); Ibid, III, no.639, pp.10-12 (*septuaginta lancee equestres*).

¹⁶ "...in dicto castro, ad presens sunt, decem ballistarii, qui nullo modo essent sufficientes, ad deffensionem dicti castris, et semper fuerit obseruatum, quod dicto castro succurritur...Quod per nostros pagatores armamenti, solidentur ballistarii quatuor...". AAV/III, no.679, p.55-56.

¹⁷ AAV/III, no.772, pp.131-132.

¹⁸ AAV/III, no.823, pp.179-180; no.852, pp.180-184; no.829, pp.185-187.

¹⁹ AAV/III, no.893, p.251.

²⁰ AAV/III, no.806, pp.157-158.

e shkaktuara nga epidemia e murtajës, e cila vrau shumicën e ushtarëve të caktuar për të ruajtur vendet e përmendura, më 8 maj 1402, Senati dërgoi 24 *balistarë* në Shkodër, Drisht dhe Lezhë.²¹ Të njëjtat qytete, më 13 nëntor 1404, i furnizoi me 40 trupa ushtarake – *balistarë*, të cilët ishin përgjegjës për mbrojtjen e këtyre komunave.²²

E gjendur në vazhdimësi para rezistencës së feudalëve shqiptarë, sidomos nga Balshajt, në gusht të vitit 1405, kapiteni venedikas i Gjirit, Marino Karavello bënte vlerësime për mënyrën se si do të mund të qetësonte rajonet e sapo pushtuara, domethënë Ulqinin, Tivarin dhe Buduan. Në vlerësimet e tija ai llogariste se për ta dëbuar Balshën III, i nevojiteshin të kishte në këtë rajon, në dispozicion të tij, të paktën 300 kalorës dhe 200 këmbësorë. Prej këtyre, gjatë tetorit të të njëjtit vit, për në Arbërinë venedikase u nisën vetëm 100 këmbësorë. Në luftën e tij përballë Venedikut, Balsha III përdori gjithashtu turqit dhe sllavët.²³ Nuk ishte medoemos thjeshtë potenciali ushtarak i Balshajve që kanoste këtu Venedikun, por përkrahja që gjetën Balshajt brendapërbrenda provincës venedikase. Ndihma që u dhanë osmanët Balshajve me trupa apo së paku me mjete diplomatike, e rëndoi gjendjen e venedikasve. Përballë këtij rreziku, me të shpejtë, Venediku vendosi nisjen e 100 *heshtarëve* dhe 100 *këmbësorëve* të planifikuar më parë.²⁴

Risi të dukshme për Venedikun si një vend me ndikim të fortë ekonomik, në fillim të shek.XV, ishin institucionet ushtarake. Krijimi i një force të qëndrueshme për të mbrojtur shtetin e fituar rishtas ishte risia e vërtetë e asaj periudhe. Konvergjencat midis realiteteve ekonomike dhe politike u forcuan gjatë shek.XIV. Venediku, për aq sa ishte e mundur, u përpoq ta zgjidhë dilemën me mjete paqësore. Lufta shihej gjithmonë si mjeti i fundit, i cili ishte jo vetëm i kushtueshëm, por edhe jashtëzakonisht i dëmshëm për rrjedhën e lirë të tregtisë.

²¹ “*Quia propter epidemiam qui vigit in partibus Scutari, Drivasti et Alexi, defecerint multi de ballistariis deputatis ad custodiam dictorum locorum...balestarios vigintiquatour...debeant dicti ballistarii diuidi in dictis tribus Castris per suprascriptum Comitem et Capitaneum nostrum Scutari videlicet duodecim in Scutaro, Sex in Drivasto, et sex in Alexio, Cassando in Scutaro loco istorum duodecim qui mittuntur...*”, AAV/III, no.954, pp.310-311.

²² AAV/III, no.1092, 440-441.

²³ “*...ad minus equites trecentos et pedites ducentos...*”, AAV/III, no.1136, p.479;

AAV/IV, no.1722, pp.202-203.

²⁴ AAV/V, no.1238, pp.16-17.

Nëse nevoja për një angazhim të përhershëm ushtarak doli të jetë shumë ngadalë në kontinentin italian, një angazhim i tillë ishte i dukshëm shumë më herët në zotërimet venedikase jashtë shtetit.

Sa i përket fushës së vendimmarrjes ushtarake, që në fillim të pushtimeve, Republika e Shën Markut, vendoste për politikën që duhej ndjekur në zotërimet e saja. Kështu, vendimet në lidhje me paqen dhe luftën, dhe çështjet kryesore diplomatike dhe ushtarake, u diskutuan dhe përfunduan në Senat në mënyrë tradicionale. Në këtë drejtim, Senati i jepte urdhrat rektorit të tij, i cili pastaj duhej të ndiqte udhëzimet e urdhërdhënësit. Me një fjalë, vendimmarrja ushtarake ishte përfundimisht përgjegjësi e Senatit. Ajo ishte përgjegjëse për furnizimin e trupave dhe dërgimin e trupave edhe në Arbërinë venedikase. Evokimi i gjatë i zhvillimeve dhe i masave ushtarake të ndërmarra nga Sinjoria për të siguruar zotërimet e saja rezultoi të jetë i mërzitshëm, por në të njëjtën kohë shumë informues mbi luftimet e shpeshta të përjetuara nga rajoni.²⁵

Forcat e mëdha të kalorësisë së përhershme dhe mekanizmat për rekrutimin dhe vendosjen e shpejtë të ushtrive kishin përparësi mbi investimet në mbrojtje të përhershme. Nivelet e vazhdueshme të luhatshme të shpenzimeve ushtarake dhe luhatjet midis politikave të lakmisë dhe kujdesit çuan në një zhvillim të çrregullt të nënstrukturave thelbësore të financimit dhe organizimit ushtarak të Venedikut.²⁶

Mirëmbajtja e garnizoneve lokale

Mirëmbajtja e garnizoneve lokale ishte përgjegjësi e Komunave. Ato financoheshin nga të hyrat që gjeneronte ajo. Shumica e kursimeve u bënë duke i zvogëluar shpenzimet. Më 19 maj të vitit 1401, Senati konkludoi se shpenzimet në Shkodër dhe Drisht ishin të tepërta. Për të korrigjuar këtë, ai pranoi kërkesën e rektorit të Shkodrës, për të shkarkuar të gjithë mercenarët e dërguar kohëve të fundit.²⁷

Si rregull i përgjithshëm ishte që rrethanat nuk lejonin shpërbërjen e trupave. Përkundrazi, nevojat, shpesh kërkonin që ushtarët të mbaheshin në postet e tyre, edhe në fund të kontratës së tyre, dhe t'i vazhdonin për një ose më shumë muaj. Kështu, kontrata e mercenarëve të dërguar më 4 shkurt 1397, në Shkodër dhe Drisht, përfundoi me 24 mars. Senati udhëzoi kapitenin të vlerësonte nëse ishte e nevojshme që rektorët e Shkodrës dhe

²⁵ Mallet, *The Military Organization*, 159-160.

²⁶ Ibid, 4-5.

²⁷ AAV/III, no.876, p. 235.

Durrësit, t'i lironin apo t'i mbanin ushtarët e tyre. Por, nëse ata preferojnë t'i mbajnë ato forca, atyre nuk mund t'u vazhdohej paga për më tepër se dy muaj shtesë.²⁸ Vlerësim i bërë, nga rektorët e Durrësit dhe Shkodrës për t'i mbajtur trupat deri më 24 maj, në fakt deri në ardhjen e ushtarëve të ardhshëm, domethënë 50 kalorës në Durrës dhe të njëjtin numër në Shkodër, ishte një problem financiar për rektorët e qyteteve të përmendura.²⁹

Për sa kohë vazhduan përplasjet me Gjergj Strazimirin, Venediku u detyrua t'i mbajë njësitë ushtarake. Por duke konsideruar shpenzimet e mëdha që duheshin përballuar në Shkodër e në Drisht, në prill 1401, Senati vendosi lirimin si të kalorësve, ashtu edhe të këmbësorëve.³⁰ Në fakt, me rastin e kontraktimit të një ushtari, Venediku zotohej që brenda një periudhe prej pesëmbëdhjetë ditësh para përfundimit të shërbimit, do ta njoftonte nëse do rinovonte kontratën edhe për një ose disa muaj, apo do ta konsideronte atë të përfunduar.³¹

Pagat e ushtarëve, të cilat i paguante Venediku, ndryshonin sipas funksionit të tyre. Në mesin e këmbësorisë, kishte një ndryshim në trajtimin midis këmbësorisë së thjeshtë dhe *balistarëve*. Kështu, në maj të vitit 1409, ky i fundit merrte 15 libra në muaj, kundrejt 13 libra që merrte një këmbësor i thjeshtë.³²

Në gusht 1396, drejtuesit e *heshtarëve* (*lancear*-lloj kalorësi që luftonte me një hesht), fillimisht, nënshkruan kontratë për gjashtë muaj, ndërsa katër vjet më vonë ata u kontraktuan për tetë muaj. Kohëzgjatja e kontratës shoqërohej me një ulje të pagës. Sidoqoftë, Venediku siguronte një afat prej pesëmbëdhjetë ditësh në 1396, deri në një muaj në vitin 1400, për të vendosur nëse do t'i mbante më gjatë në shërbim heshtarët e kontraktuar. Në këto raste, heshtarët merrnin shpërblimin e tyre muaj për muaj. Akti i gushtit i vitit 1400 jep detaje për udhëheqësit e heshtarëve. Katër oficerë nënshkruan kontratë: *Pasius de Furlivio* dhe *Gabriele de*

²⁸ AAV/III, no.677, pp.51-53.

²⁹ "...sumus contenti quod firment adhuc omnes dictas gentes, per unum aliurn mensem completurum xxiiij Maji, dicendo eis, ad terminum stabilitum, quod ad finem dicti mensis..." AAV/III, no.687, pp.57-58.

³⁰ AAV/III, no.876, p.235

³¹ "Cum gentes armigere, que sunt ad stipendium nostrum, in partibus durachii, et scutari, compleant firmam suam, die 24 mensis Martii prox. futuri, ante cuius firme complementum, dominatio nostra promisit, dictis gentibus Respondere, per quindecim dies, et eis notificare, si dominatio prefata, vult eos amplius, ad suum stipendium vel non,..." AAV/III, no.677, pp.51-53.

³² "...solidandis et mittendis ad partes Albanie ordinetur quod peditibus dentur libre XIII... et libre XV pro ballistario...in mense...", AAV/V, no.1428, pp.242.

Tasino, së bashku, do të komandonin në Shqipëri një njësit prej 28 heshtarësh, *Johannes Fanuti* do të drejtonte 8, dhe në fund *Brunorius de Placentia* do të udhëhiqte katër.³³

Sipas rregullit, pasi të kenë nënshkruar dhe treguar garanci të mjaftueshme, oficerët e heshtarëve do të merrnin një pjesë të vogël të pagës së tyre, dy muaj në 1396, tre muaj në vitin 1400. Ata do të shkonin në luftë në Shqipëri, përkatësisht në zotërimet venedikase, me anije dhe me shpenzimet e Republikës. Ata nuk mund të kërkonin pagë të dyfishtë ose ndonjë muaj shtesë, ose të blinin një kalë tjetër. Një klauzolë parashikonte edhe rastet e ngordhjes së kalit, dhe në këtë rast Republika i jepte heshtarit një periudhë prej dymbëdhjetë ditësh për ta zëvendësuar atë. Kështu, Venediku detyrohej të transportonte kuaj përmes detit në zotërimet e veta në “Shqipërinë venedikase”. Një diskutim i 13 qershorit të vitit 1419, konfirmon këtë praktikë. Atë ditë, Senati përmend vonesën në nisjen e një ngarkese kuajsh të destinuar për ushtrinë në Shkodër, një vonesë e shkaktuar nga madhësia e vogël e anijeve. Kalorësit gjithashtu mund të blinin vetë kalin, drejtpërdrejt në qytetet ku ata shërbenin.³⁴

Një klauzolë tjetër, parashikonte ndalimin e disa prej abuzimeve të mundshme. Disa zyrtar, në një përpjekje për të mashtuar punëdhënësin e tyre për të fituar sa më shumë para, regjistronin një kalorës disa herë, si një heshtar i ndryshëm, vepër e ndëshkuar nga Republika. Me rastin e përcaktimit për të shërbyer në ushtri në shërbim të Republikës, heshtarët duhej të jepnin betimin e besnikërisë, “*fidelitatis*”, ndaj Venedikut. Ata detyroheshin t’i bindeshin çdo urdhri të Republikës, ose përfaqësuesit të saj ushtarak. Në terren, të burgosurit e kapur, si dhe mallrat e plaçkitura u përkasin atyre. Heshtarët kishin kufizime të caktuara për t’i evituar të gjitha llojet e abuzimit. Ata nuk mund të vjedhin ose plaçkitin pa autorizimin e Venedikut. Nëse këmbësorët dhe kalorësit luftonin nën komandën e kapitenit të tyre, ata duhet të merrnin një pjesë të plaçkës siç është zakon. Po kështu, ata nuk kishin të drejtë të përdornin në veprimin e tyre, ushtarë të paguar nga Venediku.³⁵ Jo në pak raste, rektorët ankoreshin për mungesën e parave për të paguar ushtarët e tyre. Në të vërtetë me ndërhyrjet e turqve ose gjatë luftërave me Balsha III, të hyrat e qyteteve zvogëlohen në vazhdimësi. Prej andej rridhnin kërkesat e rektorëve për ndihmë financiare nga ana e Republikës. Më 13 nëntor të vitit 1404, rektori i

³³ AAV/III, no.644, pp.18-19; Ibid., no.831, pp.188-190.

³⁴ “...ne maior expensa sine fructu occurrat vadit pars quod omnes diti equi mittantur ad exercitum nostrum”, AAV/X, no.2342, pp.136-137.

³⁵ AAV/III, no.644, pp.18-20; Ibid., no.831, pp.188-190.

Drishtit, duke pasur parasysh varfërinë e tyre ekstreme, iu lut Senatit të siguronte mercenarët, në mënyrë që ata "të jetonin dhe të bënin nder" për Republikën. Senati e këshillon që t'u japë pagën e tyre çdo gjashtë muaj, në vend të çdo katër muaj siç ishte bërë zakonisht. Ai i kujtonte se këta ushtarë duhet të financohen drejtpërdrejt nga të ardhurat e Drishtit dhe t'i lejonte atij që nëse këto të ardhura nuk janë të mjaftueshme, t'i drejtohet vetë kontkapitenit të Shkodrës.³⁶

Më 28 shtator 1408, mercenarët e Tivarit u ankuan se nuk ishin paguar. Atje përsëri, Senati urdhëroi rektorin e tij të Shkodrës të sigurojë nevojat e këtyre ushtarëve, falë kontributeve të Qeverisë. Por kontkapiteni i shkruan Republikës se ishte e pamundur t'i paguante ata. Në mungesë të dërgimit të mjeteve financiare nga Venediku, ai lejoi të shkonin Venedik disa mercenarë për t'i kërkuar Senatit livrimin e pagave të prapambetura.³⁷

Më 24 Mars 1412, i përballur me vështirësitë e pareshtura që ndeshi kontkapiteni i Shkodrës për të paguar ushtarët e tij, Senati e urdhëroi atë të riorganizonte sistemin tatimor në këtë rajon, në mënyrë që të mblidhte më mirë taksat. Më herët, qeveria kishte refuzuar të paguajë rrogat e tyre, të cilat duhej të financoheshin nga të ardhurat e qytetit në fjalë.³⁸ Megjithatë, disa muaj më vonë, Venediku ishte detyruar të dërgojë një shumë të konsiderueshme parash për pagesën e trupave të tij dhe veçanërisht oficerëve të natës dhe kapitenëve të sektorëve, të ngarkuar me ruajtjen e qytetit, të cilët pritnin rrogat e tyre për disa muaj "*pa pasur para për të jetuar*".³⁹ Më 28 maj 1419, në mes të një konflikti me Balshën III, rektori i Shkodrës kishte nevojë për para për të paguar mercenarët e tij. I gjendur në vështirësi, Senati i shkruan atij, që në rast se i mungonin paratë, për të siguruar pagat e këtyre ushtarëve t'i kompensonte në verë dhe grurë.⁴⁰

Problemi i pagesës së ushtarëve, shpjegohet me rënien e cilësisë së tyre. Si pasojë, jo vetëm që shumicës së këtyre ushtarëve u mungonte aftësia luftarake, por edhe motivi dhe disiplina e tyre gjithashtu linte për të

³⁶ "*Preterea pro parte stipendiariorum et ballistariorum nostrorum drivasti nobis fuit humiliter supplicatum, quod eis de pagis suis, preteritis presentibus et futuris, considerata et extrema paupertate eorum vellemus subuenire, ut possint vivere, et facere honorem nostri dominii... ad solutionem predictam, tunc requirere debeatis Comitem et capitaneum nostrum scutari...*", AAV/III, no.1094, pp.442-443.

³⁷ AAV/V, no.1377, pp.174-175; Ibid., no.1411, pp.210-211.

³⁸ AAV/VI, no.1722, pp.202-203.

³⁹ "*...ab officialibus de nocte et capitibus sexteriorum...debere habere pagas suas de pluribus mensibus et quod non habent de quo vivere...*", AAV/VI, no.1778, pp.253-254.

⁴⁰ "*... non haberent denarios pro faciendo subventionem dictis stipendiariis debeant de vino et blado nostri comunis eisdem subvenire...*", AAV/X, no.2331, p.126.

dëshiruar. Në shtator 1399, kontkapiteni të Shkodrës shprehte shqetësimin se në mesin e ushtarëve të tij kanë mbetur shumë pak ushtarë me vlerë ("*boni homines*") dhe të aftë për luftë kundër turqve. Andaj, për shkak të refuzimeve dhe mosgatishmërisë për të kryer shërbimin e tyre, veçanërisht mbi kalë, qeveria pajtohej me kërkesën që rektori i Shkodrës të shkarkonte të gjithë këta ushtarë dhe në vend të tyre të dërgojë 30 të tjerë nën komandën e dy oficerëve (*komestabël*).⁴¹ Një gjendje e tillë e shkarkimit të ushtarëve dhe zëvendësimit të tyre më të tjerë për shkaqe të njëjta do të jetë e pranishme në vazhdimësi gjatë fillimit të shek.XV, edhe në Lezhë, Tivar, Ulqin etj.⁴²

Me kërcënimin e vazhdueshëm që vinte nga Balsha III, besnikëria e vendasve por edhe e rekrutëve të huaj në ushtinë venedikase vihej në dyshim. Gjithashtu, *Serenisima* ishte e vetëdijshme se ajo duhej të sigurojë pagat e tyre. Në shtator të vitit 1412, provedidori venedikas, Bertuccio Diedo, informonte se Ulqini ishte në varfëri të madhe dhe se banorët e saj po përballeshin me vështirësitë të shumta për të jetuar atje, por disa prej tyre, nëse do paguheshin, do ta mbronin me forcë këtë qytet. Senati urdhëronte rektorin e qytetit, që për ruajtjen e saj, t'i shpërblejë 50 shqiptarë ndër më besnikët dhe më të përshtatshmit për profesionin e armëve, për t'i nxitur ata në mbrojtjen e këtyre zotërimeve.⁴³

Në fillim të vitit 1418, Balsha III filloi disa sulme ushtarake mbi zotërimet e Republikës. Për mbrojtje, ajo vendosi të dërgojë një kompani prej 25 deri në 30 ushtarë, të cilët do dislokoheshin në kështjellën e Shkodrës. Senati ngarkoi rektorin e tij t'i shkarkojë këmbësorët që nuk kishin treguar mjaftueshëm besnikëri, kurse një pjesë tjetër të ushtarëve të tjerë që ishin të caktuar për mbrojtjen e qytetit dhe ishin të dyshimtë, duhet të transferoheshin në rrethinat e Shkodrës, në mënyrë që ata të përjashtoheshin nga mbrojtja e një pozicioni strategjik. Nëse ndonjëri prej tyre shpallej fajtor për tradhti, atëherë ndaj tij do të merreshin masa të nevojshme. Në të vërtetë, nuk kaloi veçse një vit (1419), dhe njësitë e këmbësorisë së dërguar nga Republika në vitin 1418 në Shkodër, u pushuan nga shërbimi. Por, në vend që të ktheheshin në Venedik, ato kaluan në shërbim të Balshës dhe morën pjesë në sulmet e tij kundër zotërimeve të Sinjorisë.⁴⁴

⁴¹ AAV/III, no.768, pp.128-130.

⁴² AAV/III, no.796, pp.149-150; no.797, p.151; AAV/V, no.1281, p.54; no.1395, pp.191-198; 1427, pp.240-241.

⁴³ AAV/VI, no.1769, pp.245-246.

⁴⁴ AAV/X, no.2225, pp.8-9; no.2305, pp.103-104.

Ushtarët e dërguar nga Venediku, në përgjithësi ishin të huaj dhe vinin nga vende të ndryshme, ndonëse dokumentet e kohës ofrojnë shumë pak detaje për origjinën e tyre etnike dhe gjeografike. Në shumë pak raste dokumentet përmendin prejardhjen gjeografike të ushtarëve të dërguar në Shqipërinë venedikase. Kështu, *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417* në mesin e pronarëve të ndryshëm të tokës në rrethin e këtij qyteti, përmend edhe disa ushtarë. Pas sulmeve të para të Balshës III dhe kryengritjeve që pasuan, Venediku konfiskoi pronat e kryengritësve, i dëboi nga vendi, kurse pronat e konfiskuara ua shpërndau mbështetësve, karriera e të cilëve varej drejtpërdrejt nga autoriteti i tij. Duke pasur parasysh rëndësinë e ushtarëve për mbrojtjen e këtyre pronave dhe problemet e pagave të qenësishme në konflikte të shpeshta, rektorët u ndanë atyre një tokë për t'u siguruar të ardhura shtesë. Për ta stabilizuar Shqipërinë venedikase, senati u mbështet pikësëpari mbi mercenarët e huaj, të cilët përfituan toka në pika kuqe strategjike të përbëra nga truall, vreshta e toka bujqësore. Në mënyrë të qëllimshme u vendosën përreth malit të kështjellës së Shkodrës mercenarë të huaj, të cilët përgjigjeshin edhe në kohë paqeje për kështjellën në mënyrë që të mbrohej nga ndikimi i vendasve. Kështu, në *Regjistrin e Shkodrës*, përveç një shqiptari, në mesin e të privilegjuarve ishin nëntë ushtarë të tjerë dhe dy *komestabël* që vinin nga rajone të tjera të huaja: Kotorri, Anglia, Hungaria, Italia (veçanërisht *Modena*, *Udine*, *Vicensa*, *Pisa*, *Senja*, *Parma*, *Korone*, *Fiume*, etj).⁴⁵

Venediku rekrutoi me pagesë edhe shqiptarë për mbrojtjen e zotërimeve të tij, por më pak të paguar sesa kolegët e tyre të huaj. Kalorësit *latinë* ose të huaj në fakt merrnin pesë dukate kundrejt katër që merrte një shqiptar.⁴⁶ Disa prej tyre morën si shpërblim një kalë. Kjo konsiderohej si një privilegj, meqë, posedimi i kuajve rriste prestigjin e poseduesit të tij, aq më shumë kur Venediku mbështetej veçanërisht në shërbimin ushtarak të kalorësve. Andaj, nuk mungonin rastet kur kalorësit shqiptarë tregonin besnikëri dhe “heroizma” në shërbim të Republikës. Kështu, kur një kalorës shqiptar me mbiemrin Sakati (Sachati), i cili sillej “besnikërisht dhe burrërisht”, u vra në luftim, me rekomandimin e kontit të Shkodrës,

⁴⁵ Koncesione të tilla i ishin bërë: *Pazetit nga Mutina* (Modena), *Johannes nga Vinçensa*, *Johan Anglezit*, *Nikollës nga Udine*, *Mateut nga Kotorri*, *Sagjinit nga Hungaria*, *Pjetrit dhe Simonit nga Parma*, *Nikollës nga Siena* (Signa), *Pjetrit nga Korona*, *Skalorzes nga Pisa*, *Antonit nga Fiume*, etj. (*Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, përg. Injc Zamputi, Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 197, 24-25, 135, 153).

⁴⁶ “...in ratione librarum quatuor soldorum quinque pro ducato, Albanenses habere habeant ducatos quator in dicta ratione...”, AAV/III, no.1032, pp.384-385.

shpërblimi për meritat e tij, i barazvlefshëm me çmimin e tre kuajve, iu nda djemve të tij, për sa kohë që ata do t'i shërbenin Venedikut. Një ushtar tjetër shqiptar, Teodor Tasilli nga Drishti, gjatë rrethimit të qytetit të tij, la gruan, fëmijët dhe të gjitha pronat e tij, dhe hyri në kështjellën e Drishtit për të luftuar atje fort, siç dëshmohet nga një letër e rektorit të Shkodrës. Si shpërblim për besnikërinë e tij, më 23 tetor 1419, Venediku i ndau një kalë dhe pagë të ushtarëve shqiptarëve, dhe një kalë tjetër "*ad italicam*", dhe pagë të nivelit të ushtarëve italianë.⁴⁷

Sa i përket komandës ushtarake ajo ishte në duart e një kapiteni gjeneral. Pak dokumente e përmendin këtë funksion. Në gusht të vitit 1396, Senati parashikoi zgjedhjen e një kapiteni për trupat e dërguara në zotërimet e tij, në Shqipërinë veneciane, por më në fund hoqi dorë. Sidoqoftë, ky dokument jep detaje të caktuara mbi kushtet e këtij funksioni. Ai do të zgjidhej në Senat për një periudhë prej gjashtë muajsh, dhe do të marrte një pagë prej 100 dukatesh në muaj, me të cilën do të paguajë një shoqërues, një noter, katër shtëpiakë të armatosur, tre "*ragatos*" dhe një stallë prej nëntë kuajsh, pesë prej të cilëve do të kishin një çmim nga 30 dukatë e lartë. Kapiteni në fjalë duhet të kishte nën komandën e tij 10 kujdestar në formë të *gardës personale* për ruajtjen e tij, të pajisur me ushta. Niveli i rojës personale, ishte edhe një tregues i prestigjit të këtij funksioni. E gjithë paga e tij do t'i paguhej në Venedik, në mënyrë që të kishte mjetet e duhura financiare. Kapiteni duhej të vinte domosdoshmërisht nga fisnikëria venedikase, gjë që është e kuptueshme duke pasur parasysh pozitën që ai duhet të mbante. Ai dhe familja e tij do të sillej me anije luftarake në Shqipëri dhe në mënyrë të ngjashme do të kthehej në Venedik, me përfundimin e mandatit.⁴⁸

Megjithatë, në fund, ky propozim u refuzua nga Senati. Pa dyshim për shkaqe ekonomike, më 25 shtator të viti 1396, Venediku preferoi të caktojë në këtë funksion një nga tre proveditorët e dërguar në Shkodër, Jakob Gradonicon, si kapiten të këtyre trupave.⁴⁹ Edhe pas skadimit të mandatit, në shkurt të vitit 1397, Senati insistoi ta mbajë në këtë detyrë Jakob Gradonicon.⁵⁰

⁴⁷ AAV/VIII, no.2177, pp.381-382; "...*quod habeant unum alium equum ad italicam cum soldo et conditione aliorum italicorum...*", AAV/X, no.2381, pp.172-174.

⁴⁸ AAV/III, no.641, pp.13-14.

⁴⁹ "*Quia nobilis vir ser Jacobus Gradonico miles, qui est electus et remansit prouisor prouisor et gubernator gentium nostrarum, non est presentialiter in Venetiis...*", AAV/III, no.655, pp.32-33.

⁵⁰ "...*in bona gratia, Quod committatur viris Nobilibus, ser Jacobo Gradanico militi, gubernatori dictarum gentium ser Francisco Dandulo, baiulo et capitaneo Durachii, et ser*

Më 15 dhjetor 1405,⁵¹ Republika, pasi dërgoi ushtarë, vendosi përsëri në këtë pozitë kapitenin Antonio Sclavo (Anton Sklavi). I kënaqur me sjelljen e tij, Venediku i ofron atij më shumë përgjegjësi. Më 7 qershor 1403, Republika e kishte caktuar Sklavin në një mision të knjazi serb Stefan Lazareviqit, për të negociuar një traktat tregtar. Ai duhet të merrej vesh për detyrimet dhe taksat që duhet të paguanin tregtarët venedikas.⁵² Në nëntor 1404, përballë sulmeve të Balshës III, Senati ndërmori veprime ushtarake. Me kërkesë të rektorit të Shkodrës, Anton Sklavi si *komestabël* duhej të drejtonte një skuadër balistarësh dhe 25 kalorës. Dy muaj më vonë, më 10 janar 1405, Senati urdhëroi Pagatorët e Armëve në Venedik të paguanin 12 kalorës për të shoqëruar Anton Sklavin, i cili duhej të paraqitej sa më shpejt në Shkodër për të marrë komandën e 25 kalorësve.⁵³

Në dhjetor 1405, atë e gjejmë përsëri në Shkodër, pasi Venediku dëshironte t'i besonte funksionin e kapitenit të përgjithshëm Anton Sklavit, nëse këtë post nuk do ta merrte proveditori Eustachio Coco (Heustak Kauku). Ky eventualitet tregon besimin e Senatit në këtë personalitet.⁵⁴ Akti i fundit që e përmend Antonin ishte lidhur me vendin e tij të origjinës. Ai vinte nga Treviso dhe kishte arritur të hyjë në administratën lokale falë karrierës së tij ushtarake. Më 4 maj 1406, ai ishte në postin e zëvendës-podestas në Drisht.⁵⁵

Edhe shumë *komestabël* tjerë u dalluan në shërbim të Republikës. Kështu Petro de Corono (Pjetri nga Korona), *komestabël* në kalanë e Shkodrës, në prill të vitit 1418, u shpërblye nga përfaqësuesit venedikas për trimërinë që tregoi në mbrojtjen e kësaj kalaje, veçanërisht gjatë revoltës së

Johanii Capello, comiti et capitaneo Scutari... facta autem terminatione Retinendi dictas gentes, debeat, Remanere, capitaneus earum, vir nobilis, ser Jacobus Gradonico miles predictus pro illo tempore, quo Remanebunt dicte gentes", AAV/III, no.677, pp.51-53.

⁵¹ AAV/III, no.1159, pp.496.

⁵² AAV/III, no.1041, pp.396-397.

⁵³ AAV/III, no.1092, p.440; no.1103, pp.450-451. Më 17 qershor 1405, Venediku i dha leje që të kthehej në Venedik për dy muaj për të shëruar nga një sëmundje (AAV/III, no.1124, p.471); *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I (1400-1405), përg.: Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, Tiranë: Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1987, no.483, pp.548-549.

⁵⁴ AAV/III, no.1159, pp.495-496; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.575, pp.645-646.

⁵⁵ "*de Trarvisio... et ad presens vice potestati Drivasto...*", AAV/III, no.1182, p.522; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.II (1406-1410), Pjesa e parë, transkriptuar dhe përkthyer Injac Zamputi, Pranvera Bogdani; redaktoi dhe përgatiti Edmond Malaj, Tiranë: Akademia e studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2019, no.38, p.125-126.

Shkodrës. Në të vërtetë, ai shfaqet në *Regjistrin e Shkodrës* si pronar i një kopshti, i cili i siguron atij disa të ardhura shtesë dhe po ashtu i ishte rritur edhe paga.⁵⁶ Një vit më vonë, komestabëli tjetër i kalasë së Shkodrës, Antonio Samitarius shfaqet në Venedik, duke kërkuar të njëjtën rritje të pagës. Edhe ky ishte gjithashtu shumë besnik në shërbim të Venedikut. Pas një debati, Senati vendos që "*është e drejtë që ai të trajtohet në të njëjtën mënyrë si Petro de Corono*", dhe t'i jepej atij i njëjti shpërblim si kolegut i tij.⁵⁷

Edhe ushtria detare e Venedikut përdorej sa herë që konsiderohej e nevojshme për të rikthyer sigurinë në zotërimet e saj. Për të transportuar trupat saj, ajo përdorte galerat dhe brigantinat ushtarake. Më 12 janar 1405, kur Venediku vendosi të ripushtonte qytetin e Shkodrës, kishte një galerë, e cila do të kishte 40 balistarë, si dhe dy komestabël. Gjithashtu galera në fjalë duhet të marrë Anton Sklavin, Andrea Spanin dhe të tjerët që do të konsideroheshin si të nevojshme.⁵⁸ Përveç këtyre trupave, Venediku vendos të përdorë edhe disa nga anijet e saj për mbrojtjen e Shkodrës. Andaj ajo delegon edhe një brigantinë të destinuar për rojën e qytetit në Liqenin e Shkodrës. Më 30 tetor 1407, Senati mendoi të ndryshonte kapitenin e kësaj anije, i cili kishte arritur në fund të mandatit të tij, dhe të dekretonte që pasardhësi i tij të mbante të njëjtën pagë.⁵⁹ Më 10 nëntor 1407, kapiteni i ri ende nuk ishte emëruar. Senati vendos të emërojë për këtë detyrë një fisnik më shumë se sa një "*popullor*". Ai do të komandonte një galerë të deleguar te roja i Liqenit të Shkodrës me misionin që ti shfaroste armiqtë, "*dannum et que exterminium inimicorum nostrorum*".⁶⁰ Njëmbëdhjetë ditë më vonë, Senati zgjodhi Paul Blanko si komandant të kësaj anije. Për këtë, ai do të merrte një pagë prej 15 dukatesh në muaj gjatë misionit të tij.⁶¹ Burimet venedikase përsëri njoftojnë se një flotë e vogël u dërgua në Shkodër në

⁵⁶ AAV/VIII, no.2087, pp.158-159; "Një copë toke për kopsht, që gjendet nën malin e Shkodrës. Kufijtë e saj janë: nga njeri krah i saj rruga publike nëpër të cilën shkohet te forcoma, nga krahut tjetër muret e vjetra, aty ku më parë ka qenë qyteti, nga krahut tjetër gëlqerorja, nga krahut tjetër i saj rruga nëpër të cilën shkohet në kështjellë, që është prapa shtëpisë së Zorzi Bushatit. [Toka është] dhënë e lëshuar zotit Pjetër nga Korone komestabël në kështjellën e Shkodrës, dhe për këtë tokë i përmenduri zoti Pjetër duhet të paguajë pesëmbëdhjetë solda në vit". (*Regjistri i Kadastrës së Shkodrës*, 25, 134).

⁵⁷ AAV/X, no.2312, p.110.

⁵⁸ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.485, p.550.

⁵⁹ AAV/V, no.1303, p.84.

⁶⁰ AAV/V, no.1304, pp.85-86; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.II, no.190, pp.370-373.

⁶¹ AAV/VI, no.1308, p.89; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.II, no.195, pp.379-380.

nëntor të vitit 1419. Rektori i qytetit në fakt paralajmëronte Venedikun për kërcënimin e paraqitur nga Balsha III mbi lumin Bunë. Ky kërkonte të përmirësonte disa fortifika mbi këtë lumë dhe pikërisht në pikat e Shën Nikollës dhe Shën Shirgjit, në mënyrë që të parandalojë furnizimin e qytetit. Sidoqoftë, rruga detare mbetet e vetmja e mundshme për transportimin e ushqimit në Shkodër. Gjithashtu, më 16 nëntor, Senati vendosi të armatoste *katër barka, dy galera* me nga 20 deri në 22 rreshta me nga 12 *balistarë* secila dhe t'i dërgonte, siç thuhej “për të shpëtuar Shkodrën”.⁶²

Për mbrojtjen e zotërimeve të saj, Republika u mbështet edhe te zotërit vendas, me të cilët kishte hyrë në aleancë. Paktet e marrëveshjeve parashikonin një shërbim ushtarak të këtyre të fundit, me kërkesë të Republikës. Në këmbim, ata merrnin kompensim. Në shtator 1396, Venediku mori në konsideratë ofertën e Komino Shpatës dhe Niketë Thopisë, për t'i shërbyer Republikës me trupat e tyre, në këmbim të shpagimit. Ata siguronin se të mund të vënin në dispozicion të Venedikut 400 kalorës dhe 1000 këmbësorë.⁶³ Më 6 tetor 1396, për të konfirmuar aleancën e përfunduar nga rektori i saj në Durrës, Venediku, u ofroi një copë pëlhurë fiorentinase për ta ndarë në mes tyre Komino Shpata dhe Niketë Thopia.⁶⁴ Më 8 korrik 1404, Venediku i lejonte kontit Nikitë të mbante Krujën, me kusht që ai së bashku me trashëgimtarët dhe pasardhësit të mbante kalimet e hapura për tregti dhe të shërbente vetëm në rast lufte. Ai do të duhet të dërgonte njerëzit e tij për të ndihmuar vendet e trazuara, me kërkesë të rektorëve venedikas.⁶⁵ Republika e Shën Markut, gjithashtu lidhi marrëveshje edhe me vëllezërit Perlati (Dukagjini), Pal dhe Tanush Perlati, të cilët ishin ankuar për grabitjet e pësuar gjatë inkursioneve të kapitenit turk, i cili dogji fshatrat dhe shtëpitë që u përkisnin atyre. Me atë rast, ata kujtojnë vdekjen në Dalmaci të vëllait të Palit, Progamit, birit të Lekë Dukagjinit në shërbim të Venecias, përkatësisht në një betejë nën kështjellën e Shatit. Vëllezërit Perlati ofronin t'i shërbenin Venedikut me dhjetë kalorës, kurse gratë dhe fëmijët e tyre do t'i sillnin në Shkodër si pengje. Senati pranoi ofertën e tyre më 27 maj 1402 dhe në këmbim u dha atyre një pagë prej tre dukatesh ari në muaj secilin.⁶⁶

⁶² AAV/X, no.2385, pp.177-179.

⁶³ “...*Cominus Spata et comes Nicheta...cum CCCC equitibus et mille peditibus...*”, AAV/III, no.654, pp.29-32.

⁶⁴ AAV/III, no.655, pp.40.

⁶⁵ AAV/III, no.1082, pp.431-434; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.447, pp.510-513.

⁶⁶ AAV/III, no.959, pp.312-313; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.215, pp.300-302.

Venediku, gjithashtu gëzonte mbështetjen dhe ndihmën e dy zotërinjve lokalë veçanërisht të fuqishëm, Kojë Zakaria dhe Dhimitër Jonima. Në korrik 1399, kështjellari i Lezhës e informoi Venedikun për vullnetin e shfaqur nga Dhimitër Jonima, si "njeri mjaft i fuqishëm", për ta vënë veten nën bindjen venedikase, duke kujtuar se ai ishte fillimisht një besnik i Republikës, pastaj u rebelua dhe u kap pas turqve për një muaj, por dëshiron të kthehej tek zotëria jonë (Venediku). Ai tha se ishte gati të jepte informacion mbi veprimet e turqve dhe kërkoi që të bëhej shtetas venedikas dhe të ishte në gjendje të strehohej në tokat e Republikës, nëse do të paraqitej nevoja. Duke marrë parasysh se "*mund të jetë e dobishme vetëm ta kesh atë mik*", Senati iu bashkua sjelljes së tij më 21 korrik të vitit 1399.⁶⁷

Një vit më vonë, kjo marrëveshje nuk duket se ishte materializuar, pasi Venediku hyn në negociata me Kojë Zakarinë dhe Dhimitër Jonimen. I pari si zot i Shatit, kishte pasazhe që i lejoi turqit të kalonin, për të sulmuar Shkodrën dhe Drishtin. Ai shprehte gatishmërinë që më vasalin e tij Dhimitër Jonimën, të braktisë aleancën me sulltanin për të hyrë në një marrëveshje me Republikën. Përfaqësuesi i tyre pranon se ata u detyruan t'i bashkohen kauzës turke për të mbajtur tokën e tyre.⁶⁸ Kojë Zakaria mbante gjithashtu rrugën (vendkalimin) për në Denjë (Dagno), i cili, nëse ai ndërton një fortesë atje, do të ishte e mjaftueshme për të ndaluar inkursionet e trupave të dobëta turke që po shkatërronin ato krahina. Senati ishte i etur për të arritur një marrëveshje, duke pranuar se nuk mund të ruajë pronat e tij pa ndihmën e tij, pasi çdo vit turqit dhe armiqtë e tjerë shkatërronin këtë rajon. Ai përfundon se nuk është vetëm e dobishme, por e nevojshme të negociohet. Prandaj Venediku pranoi ndihmën në ushtarë dhe në ndërtimin e fortifikimeve në Denjë, me mjete të tjera mbrojtëse në tokat e këtyre dy fisnikëve shqiptarë. Më 7 tetor 1400, rektori i Shkodrës premtojte se ishte gati të jepte 500 dukate në vit për Kojë Zakarinë dhe 300 dukate në vit për Dhimitër Jonimën, plus strehim të familjes për secilin prej tyre.⁶⁹

Disa ditë më vonë, më 12 tetor 1400, Venediku mësoi se Bajazidi po riorganizonte forcat e tij ushtarake për të luftuar trupat turko-mongole të Timerlangut dhe se ai i bëri thirrje vasalit të tij, Kojë Zakarisë që t'i bashkëngjitej. Prandaj traktati i aleancës refuzohet.⁷⁰ Pas disfatës së

⁶⁷ AAV/III, no.759, pp.121-122.

⁶⁸ AAV/III, no.846, pp.209-212.

⁶⁹ AAV/III, no.846, pp.209-212; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.70, pp.146-150.

⁷⁰ AAV/III, no.847, p.212; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.72, pp.151.

sulltanit në Ankara, marrëveshja mund të lidhej me këta dy fisnikë shqiptarë. Më 3 nëntor të vitit 1402, Donat de Porto, kontkapiteni i Shkodrës bënë një pakt me Kojë Zakarisë dhe pranon vajzën e tij si peng. Një muaj më vonë, Senati ratifikon këtë aleancë edhe me Dhimitër Jonimën dhe i ofron një armaturë të plotë (veshje e rëndë ushtarake prej hekuri) Kojë Zakarisë, në vlerë prej 38 dukatesh.⁷¹ Më 5 maj 1403, ai konfirmon një pakt të lidhur midis Dhimitër Jonimës dhe rektorit të Shkodrës, sipas së cilës Jonima do të merrte një furnizim prej 200 perperë në vit dhe pëlthurë/stof për dy mantele dhe një armaturë.⁷²

Kur Balsha III nisi sulmin e tij të parë në 1405, Kojë Zakaria, duke ndjekur me përpikëri marrëveshjen e tij, u erdhi në ndihmë venedikasve dhe në veçanti kapitenit të tij të Gjirit, Marino Karavello.⁷³ Në janar 1406, Venediku dëshironte të përfundonte një marrëveshje të re me këta dy zotëri. Ai udhëzoi rektorët e tij të Shkodrës dhe Drishtit që të merreshin me ta dhe u jepte udhëzime që t'u ofrohej atyre provizione dhe paktet e mëparshme, por megjithatë, duke sprovuar nëse mund të bëhen provizione më të vogël sesa në marrëveshjen e mëparshme ose nëse nuk është e mundur të zvogëloheshin të paktën të jenë të njëjta si më parë.⁷⁴

Më 9 gusht 1407, Dhimitër Jonima paraqiti Senatit disa kërkesa, në mesin e të cilave, veçanërisht interesante ishte kërkesa që të bëjë bashkërendimin e ushtrisë venedikase në zotërimet e saj të mëparshme shqiptare. Jonima, thjesht propozonte të udhëhiqte, si shef, trupat venedikase që “nuk janë mësuar me këto rajone”. Duke e respektuar këtë kërkesë, Venediku iu përgjigj pozitivisht, duke pranuar se ai është kapiten i burrave të tij dhe i ushtarëve venedikas, me kusht që ata të kenë shefin e tyre të duhur. Kështu që “nëse ai do të bënte gjëra të papërshtatshme”, trupat venedikase nuk do ta lejonin atë ta bënte atë.⁷⁵ Në këtë akt, Republika prante që Dhimitër Jonima ishte nominalisht udhëheqësi i gjithë ushtrisë së saj, por fuqinë e vërtetë ia lë kapitenit të saj gjeneral. Prandaj ky emërim dukej më shumë për ta nderuar sesa i vërtetë.

⁷¹ AAV/III, no.996, p.342; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.271, pp.346-348.

⁷² “...habeat yperpera ducenta in anno et pannum pro duobus mantelis et de presenti unam armaturam...”, AAV/III, no.1028, pp.380-381; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.I, no.329, pp.395-399.

⁷³ AAV/VI, no.1525, pp.17-19.

⁷⁴ AAV/III, no.1160, pp.496-498; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek.XV*, vëll.II, no.6, pp.66-70.

⁷⁵ “...armorum non sunt assuete in illis partibus...”, AAV/V, no.1271, pp.46-47.

Një akt i 27 gushtit 1409, në të cilin nuk përmendet më kjo zyrë e shefit dhe komandantit të ushtrisë venedikase, jep detaje për aleancën e rënë dakord me Jonimën, i cili në këmbim të një sigurimi prej 100 dukatesh në vit, duhej të vendoste në dispozicion të Venedikut 200 kalorës dhe 400 këmbësorë. Megjithatë, ai ankohej se pensioni i ndarë nga Republika nuk ia mundësonte të jetojë në mënyrë të denjë, andaj dhe kërkonte një rritje. Senati refuzoi, duke e vlerësuar këtë shumë të mjaftueshme, dhe deklaroi se duhet të jetë i kënaqur me të.⁷⁶ Nga ana e tij, Kojë Zakaria ishte ende duke u treguar i dobishme për venedikasit. Në mars të vitit 1410, ai arriti të vinte prindërit e tij nën besimin dhe bindjen e Republikës, gjë që Senati e mirëpriti me dashamirësi.⁷⁷

E gjithë kjo tregon se Venediku përdori autoritetin ushtarak të elementit lokal për të forcuar ushtrinë e saj dhe për të mbrojtur zotërimet e saj. Përveç fisnikëve të mëdhenj lokalë, ajo iu drejtua edhe të tjerëve: *pronjarëve*, sjellja e të cilëve përballë Republikës mund të ndikonte në ruajtjen e dominimit të saj në rajon.

⁷⁶ AAV/V, no.1464, pp.270-271.

⁷⁷ AAV/VI, no.1525, pp.17-19.

Gjon BERISHA

SUMMARY

THE OPERATIONS AND IMAGES OF VENETIAN ARMY IN ARBERIA AT THE END OF THE XIV AND BEGINNING OF XV CENTURIES

Through the occupation of “Venetian Albania” the presence of Italian officials and military troops (mercenaries) permanently stationed in Albania was very small. The majority of the army consisted of Albanian soldiers who were put in the service of St. Mark Republic. The majority of Albanians were inclined towards Venice; this was a result of social circumstances and political events, particularly by the Ottoman danger. The most powerful uprisings against the Venetia broke up between the years 1399 to 1421, during the conflict between the St. Mark Republic and Balshaj. This period marked even the fights against the Ottomans. The Senate faced consistent difficulties to secure a sufficient number of mercenaries to serve in Arberia, partially because the fights in Albania were fierce and affected the elimination of Italian military units.

Throughout the XV century, the organization of the Venetian army continued to lean mainly on the *condotte* that were run by *condottiere*, a position between the individual and state captains. The army mainly consisted of *ballistas*, *cavalry* and *infantry*. Military decision-making was ultimately the responsibility of the Senate. The Senate was mandated to supply military troops and to send them to Venetian Albania. Municipalities bore the maintenance of local garrisons. They were funded by generated revenues and often faced difficulties paying soldiers. The Rectors frequently complained about the lack of money to pay soldiers. This affected the quality, motivation and discipline of soldiers, which left much to be desired. The salaries that Venice paid to soldiers varied according to their position. There were different payments for the random infantry and ballistas, or between Italian and Albanian soldiers. The latter were paid less than the former. To protect its possession the Republic also relied on Albanian feudal lords (Thopia, Shpata, Dukagjini, Jonima, Zakaria, etc.), who had joined the alliance. The terms of agreements provided military service in return for compensation.

